



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.278/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret : Bujar Muzaqi kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar, ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.278 datës 31.01.2025.

II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ,me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 5,500.00 Euro (Pesëmijepesëqind) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 31.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër Anr.278/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Në ankesën A,nr.278 datë 31.01.2025 theksohet se në Mbledhjen e Kuvendit Komunal në Pejë, Kryetari i Komunës së Pejës dhe njeherit kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Gazmend Muhaxheri, gjatë mbajtjes së një fjalimi, ka përdorur gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë ofenduese që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Në fjalimin e Gazmend Muhaxherit i mbajtur në Kuvendin Komunal, ndër të tjera thuhet se :

"Ju jeni qu me i hup dështimet, ata e kanë kuptu ata, që i keni krejt lamit tjera, me i mbulu me Operacione në Veri, domethonë krejt sendet çka i keni bo, jeni në funksion të politikës së sërëbisë, krejt çka keni bo nëse don me ta zbërthy, qështu e kom zbërthye, u kon qekjo"

Si provë në ankesa ka bashkangjitur Video të marra nga faqja e Komunës së Pejës, e Cila i transmeton drejtpërdrejt mbledhjet e Kuvendit Komunal, <https://www.facebook.com/share/v/1EvfBMoJM9/?> Nga minuta 43:15 e tutje deri në minutë e 43:40 Si dhe postimi në rrjetin social Facebook

Subjekti politik LDK brenda afatit të paraparë ligjor ushtron përgjigje në ankesën e parashtresit të ankesës LVV, në të cilën ankesë thuhet se nuk kemi të bëjmë me asnjë formë denigruese sepse fjalimi i kryetarit të komunës së Pejës, që është pretendim ankimor për shkelje të LZP nga ana e ankuesit, është i mbajtur nga foltorja e Kuvendit Komunal të Pejës, pra bie në domenin e kompetencave të tij si Kryetar dhe jo si kandidat për deputet, dhe nga ky aspekt ankesa është e palejuar, kurse atë që subjekti LVV mund ta ndjek ligjërisht nëse pretendon për ndonjë shkelje është padia në gjykatë, por jo ankesa në P ZAP.

Duke marrë parasysh ato që u ceken me lartë kërkojnë nga PZAP që të marr vendim meritore për rastin në fjale dhe duke u bazuar në krejt ato që u thanë kërkojnë që ankesa e subjektit LVV, të refuzohet si e pabazuar, ngase për ofendimin dhe fyerjen zakonisht deponohet padi për shpifje e fyerje në Gjykatën Themelore, por jo në PZAP.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit video incizimit të publikuar të ofruar si provë materiale e cila është publikuar në webfaqen e Kuvendit Komunal të Komunës së Pejës, shihet se në Kuvendin Komunal të Komunës së Pejës i njëjti ka përdorur gjuhë të urrejtjes duke theksuar dhe atë se *"Ju jeni qu me i hup dështimet, ata e kanë kuptu ata, që i keni krejt lamit tjera, me i mbulu me Operacione në Veri, domethonë krejt sendet çka i keni bo, jeni në funksion të politikës së sërbiisë, krejt çka keni bo nëse don me ta zbërthy, qështu e kom zbërthye, u kon qekjo"*, paneli vlerëson se gjuha e përdorur nga kandidati për deputet Gazmend Muhaxhiri është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore.

Andaj për Panelin përdorimi i një gjuhe të tillë nxit ose provokon, mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve dhe është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin në nen në mënyrë decitive thuhet se : *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisi në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Paneli, pas shikimit shkresave të lëndës (linkut) dhe CD-video incizimit të ofruar si provë materiale, rrjedh se kandidati për deputet Gazmend Muhaxhiri gjatë mbajtjes së takimit në Kuvend Komunal në Pejë, ka përdorur gjuhë denigruese e cila është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe se i njëjti ka përdorur gjuhë të papërshtatshme gjatë fjalimit në Kuvendin Komunal në Pejë, dhe vlerëson se është gjuhë denigruese, dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore.

Në Nenin 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thuhet se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro. Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 9 nën paragrafi 9.1 Rregullës Nr.01/2024, ku në mënyrë decitive thuhet se *"subjekti politik që është përfitues i fondeve*

për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesë dhjetë mijë (50,000.00)euro”.

Sipas Panelit nga përmbajtja e deklaratave të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, konsiderohet gjuhë nxitëse dhe urrejtëse *kundrejt të tjerëve* në kuadër të fushatës zgjedhore dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe në përgjithësi atmosfere destabiliteti. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga kandidatët e lartëcekur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.


Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr. 278/2025 më datë 03.02.2025

Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.40/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Rustem Thaqi, anëtarë, në çështjen juridike lidhur me ankesën Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, e duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.278/2025, të datës 03.02.2025, në seancën e mbajtur me datë, 07.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet si e themeltë ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Ndryshohet vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.278/2025, i datës 03.02.2025, dhe vendoset që: Refuzohet e pathemeltë ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.278/2025, e datës 31.01.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.278/2025, të datës 03.02.2025, është vendosur: "I. PRANOHET e bazuar, ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.278..e datës 31.01.2025. II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 5,500.00 Euro (Pesë mijepesëqind) euro. III. Detyrohet Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën - II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi."

Kundër vendimit të lartpërmendur, Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke mos i specifikuar shkaqet e ankesës, ndërsa si pretendim kryesor ankimor i saj është se vendimi i PZAP-së është marrë si rezultat i shkeljes esenciale të dispozitave procedurale dhe aplikimit të gabuar të ligjit, si dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, pasi që nuk është analizuar fjalë për fjalë fjalimi i kryetarit



të Komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri, i dhënë në mbledhjen e Kuvendit Komunal në Pejë më datë 31.01.2025, dhe se deklarimi i tillë nuk është thënë nga zyra e degës në Pejë, e as nga selia qendrore në Prishtinë, e as nga ndonjë tubim politik elektoral në Pejë apo në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me pretendim se fjalimi i tillë është nxjerrë nga konteksti dhe se në rastin konkret nuk ka elemente të gjuhës nxitëse apo të urrejtjes, me propozim që Gjykata Supreme të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj vendimin e PZAP-së, A.nr.278/2025, të datës 03.02.2025.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Subjektit Politik të dënuar me këtë vendim, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.278/2025, i datës 03.02.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 31.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër Anr.278/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendohet se në mbledhjen e Kuvendit Komunal në Pejë, Kryetari i Komunës së Pejës dhe njëherit kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Gazmend Muhaxheri, gjatë mbajtjes së një fjalimi, ka përdorur gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë ofenduese që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Parashtruesi i ankesës thekson se në fjalimin e Gazmend Muhaxherit i mbajtur në Kuvendin Komunal, ndër të tjera thuhet se: *"Ju jeni qu me i hup dështimet, ata e kanë kuptu ata, që i keni krejt lamit tjera, me i mbulu me Operacione në Veri, domethonë krejt sendet çka i keni bo, jeni në funksion të politikës së Serbisë, krejt çka keni bo nëse don me ta zbërthy, qështu e kom zbërthye, u kon qekjo"*. Me këtë parashtruesi i ankesës si provë në ankesë ka bashkangjitur video të marra nga faqja e Komunës së Pejës, e cila i transmeton drejtpërdrejt mbledhjet e Kuvendit Komunal, <https://www.facebook.com/share/v/1EvFBMoJM9/?>, nga minuta 43:15 e tutje deri në minutën e 43:40, si dhe postimi në rrjetin social Facebook <https://www.facebook.com/100044325704635/posts/1158767885610724/?mibextid=WC7FN>

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 02.02.2025 Subjekti Politik LDK ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me pretendim se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me asnjë formë denigruese, sepse fjalimi i kryetarit të komunës së Pejës, që është pretendim ankimor për shkelje të LZP nga ana e ankuesit, është i mbajtur nga foltorja e Kuvendit Komunal të Pejës, pra bie në domenin e kompetencave të tij si kryetar dhe jo si kandidat për deputet, dhe nga ky aspekt ankesa është e palejuar, kurse atë që subjekti LVV mund ta ndjek ligjërisht nëse pretendon për ndonjë shkelje është padia në gjykatë, por jo ankesa në PZAP. Po ashtu me përgjigje në ankesë theksohet se kërkojnë nga PZAP që të marr vendim meritor për rastin në fjalë dhe duke e bazuar në të lartcekurat kanë kërkuar që ankesa e subjektit LVV, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa për



ofendimin dhe fyerjen zakonisht deponohet padi për shpifje e fyerje në Gjykatën Themelore, por jo në PZAP.

Paneli, pas shikimit të video incizimit të publikuar të ofruar si provë materiale e cila është publikuar në webfaqen e Kuvendit Komunal të Komunës së Pejës, ka theksuar se shihet se në Kuvendin Komunal të Komunës së Pejës i njëjti ka përdorur gjuhë të urrejtjes duke theksuar dhe atë se: "Ju jeni qu me i hup dështimet, ata e kanë kuptu ata, që i keni krejt lamit tjera, me i mbulu me Operacione në Veri, domethonë krejt sendet çka i keni bo, jeni në funksion të politikës së sërvisë, krejt çka keni bo nëse don me ta zbërthy, qështu e kom zbërthye, u kon qekjo", andaj paneli vlerëson se gjuha e përdorur nga kandidati për deputet Gazmend Muhaxhiri është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore.

Paneli vlerëson se përdorimi i një gjuhe të tillë nxit ose provokon, mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve dhe është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Paneli, në arsyetim të vendimit më tej ka theksuar se pas shikimit shkresave të lëndës, (linkut) dhe CD-video incizimit të ofruar si provë materiale, rrjedh se kandidati për deputet Gazmend Muhaxhiri gjatë mbajtjes së takimit në Kuvend Komunal në Pejë, ka përdorur gjuhë denigruese e cila është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe se i njëjti ka përdorur gjuhë të papërshtatshme gjatë fjalimit në Kuvendin Komunal në Pejë, dhe vlerëson se është gjuhë denigruese, dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Në nenin 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thuhet se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro. Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 9 nën paragrafi 9.1 të Rregullës Nr.01/2024, ku në mënyrë decisive thuhet se: "subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesë dhjetëmijë (50,000.00) euro".

Sipas Panelit nga përmbajtja e deklaratave të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, konsiderohet gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt të tjerëve në kuadër të fushatës zgjedhore dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe të përgjithësi atmosfere destabiliteti. Sipas panelit përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që



kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë. Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga kandidatët e lartëcekur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përbën përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore. Si rezultat i kësaj këto veprime të tilla vlerësohen se janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nënpika 1.11, si dhe nenit 118 paragraf 1, për çka edhe me të drejtë subjektit politik në fjalë i është shqiptuar gjoba në pajtim me dispozitën e nenit 120 paragraf 1, nën paragrafi 1.3 të LZP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e PZAP, lidhur me aprovimin e ankesës të parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se vendimi i PZAP-së, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar në tërësi ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të vendimit të PZAP-së për arsye se:

Me provat që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë ankesa së bashku me dëshmitë e ofruara të paraqitura në PZAP, si dhe ankesa drejtuar kësaj gjykate, shihet qartë se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet se: *"1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Në lidhje me këtë, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht dëshmitë e ofruara me ankesë, shihet se kryetari i Komunës së Pejës, njëherësh kandidat për deputet i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Gazmend Muhaxheri, i cili në fjalimin e mbajtur në Kuvendin Komunal, ndër të tjera ka deklaruar se: *"Ju jeni qu me i hup dështimet, ata e kanë kuptu ata, që i keni krejt lamit tjera, me i mbulu me Operacione në Veri, domethonë krejt sendet çka i keni bo, jeni në funksion të politikës së Serbisë, krejt çka keni bo nëse don me ta zbërthy, qështu e kom zbërthye, u kon qekjo"*. Kjo shihet nga video e marrë nga fatja e



Komunës së Pejës, e cila i transmeton drejtpërdrejt mbledhjet e Kuvendit Komunal, si dhe postimi në rrjetin social Facebook, në linkun e përshkruar si më lartë.

Nga deklaratimet e cituara, Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11 të LZP-së. Deklarimet dhe postimi i cituar në mbledhjen e Kuvendit Komunal në Pejë, nga kryetari i Komunës së Pejës nuk përmbajnë fjalor denigrues që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve. Përveç kësaj, këto deklarime dhe postimi i kandidati në fjalë, nuk rezultojnë të jenë bërë në një tubim politik të LDK-së, por gjatë një debati politik në Kuvendin Komunal të Pejës, ndërsa fjalët e përdorura në Kuvendin Komunal në Pejë, nuk janë të drejtuara kundrejt një subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar, në mënyrë që të ngjall apo nxit urrejtje ndaj tyre. Në këto deklarime në asnjë moment nuk kemi thirrje apo nxitje që të ndërmerret veprime të caktuara kundër këtyre subjekteve caktuara.

Në lidhje me këtë, referuar fjalëve të përdorura nga Gazmend Muhaxheri, kryetar i Komunës së Pejës dhe kandidat për deputeti nga radhët e LDK-së, nuk rezultojnë se përmes tyre është kërkuar nga qytetarët që të ndërmerret ndonjë veprim i caktuar kundër subjektit politik LVV, mirëpo deklaratimet e tilla të kryetarit të Komunës së Pejës kanë të bëjnë me pretendimet për dështimin e subjektit politik LVV në qeverisje, ndërsa të njëjtat deklarime nuk i drejtohen qytetarëve për nxitje të urrejtjes apo me kërkesë që ndaj tyre të ndërmerret ndonjë veprim i caktuar, dhe nuk kemi ndonjë veprim apo fjalë e cila fyen apo ofendon të njëjtin subjekt. Si rrjedhojë, përdorimi i këtyre shprehjeve gjatë një debati politik në Kuvendin Komunal të Pejës, nuk mund të konsiderohet si gjuhë denigruese dhe nxitje e urrejtjes dhe shkelje e kodit të mirësjelljes, prandaj nga kjo rezultojnë se ankesa e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, është e pabazuar.

Në anën tjetër, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut - GJEDNJ, në praktikën e saj gjyqësore, lidhur me deklaratimet gjatë fushatës zgjedhore deri më tani ka trajtuar një sërë çështjesh në lidhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj-Konventës. GJEDNJ, ka theksuar se ekziston një lidhje e ngushtë ndërmjet të drejtës për zgjedhje të lira dhe lirisë së shprehjes. Në rastin Bowman kundër Mbretërisë së Bashkuar, ka theksuar se këto të drejta, veçanërisht liria e debatit politik, së bashku përbëjnë themelin e çdo sistemi demokratik. Të dy këto të drejta janë të ndërlidhura dhe funksionojnë për të përfunduar njëra-tjetrën: për shembull, liria e shprehjes është një nga "kushtet" e nevojshme për të "siguruar shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës". Zgjedhjet e lira dhe liria e shprehjes, veçanërisht liria e debatit politik, së bashku përbëjnë themelin e çdo sistemi demokratik. Për këtë arsye, është veçanërisht e rëndësishme në periudhën para zgjedhjeve që opinionet dhe informacionet e të gjitha llojeve të lejohen të qarkullojnë lirisht. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se: "*Liria e shprehjes përbën një ndër bazat themelore të shoqërisë (demokratike), një ndër kushtet bazë për progresin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu*" (Rasti "*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*", 7 dhjetor 1976, Aplikimi Nr.5493/72, paragrafi 49). Gjykata Evropiane i jep vlerë të veçantë debatit politik dhe debatit për çështje të tjera me rëndësi publike. Çdo deklaratë e bërë gjatë zhvillimit të këtij debati mund të kufizohet vetëm



atëherë kur është absolutisht e nevojshme: “Ka pak vend për kufizime të fjalimeve politike ose debateve për çështje me interes publik” (Rasti “Dichan dhe të tjerë kundër Austrisë”, shënim 13, paragrafi 38).

Andaj, në kontekstin e paraqitur duke iu referuar të cekurave më lart, rezulton se në këtë rast deklarimet dhe postimi i cituar në mbledhjen e Kuvendit Komunal në Pejë të datës 31.01.2025, nga kryetari i Komunës së Pejës, njëherësh kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, nuk përmbajnë fjalor denigrues që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë urrejtje kundrejt të tjerëve. Përveç kësaj shprehja e një mendimi të tillë në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohet si gjuhë e urrejtjes, përçarjes apo mos durimit, e aq më pak shkelje e rregullave të fushatës zgjedhore, pasi nga shprehjet e përdorura nuk plotësohen elementet bazë të gjuhës së urrejtjes, e njëjtimisht deklarimi i kandidatit për deputet në kuvendin Komunal në Pejë, aktualisht kryetar i kësaj komune nuk dëmton subjektin politik LVV. Për më tepër siç është cekur edhe më lartë, deklarimi i tillë nuk është bërë si pjesë e ndonjë tubimi politik të partisë LDK, si dhe fjalët e përdorura nuk janë të drejtuara kundrejt një subjekti, organizate apo komuniteti të caktuar, në mënyrë që të ngjall apo nxit urrejtje ndaj tyre.

Nga të cekurat më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se derisa nuk mund të ndalohen të drejtat e një subjekti, organizate, individi apo komuniteti të caktuar që në mënyrë të lirshme ti shprehin mendimet e tyre politike në kuadër të mbledhjeve dhe veprimtarisë së tyre politike, po ashtu nuk mund të sanksionohet një subjekt politik i cili mban qëndrim të kundërt kundrejt një subjekti tjetër, pa pasur ndonjë element të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët. Ndërsa, që të vie në shprehje shqiptimi i gjobës duhet të vërtetohet fakti se i njëjti subjekt me veprimet, apo fjalimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore, nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve. Prandaj, në këtë rast PZAP, nuk ka arritur të konstatoj drejtë dhe saktë gjendjen faktike dhe nuk e ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, për faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk rezulton se kemi të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, prandaj ankesa e subjektit politik LDK është aprovuar si e bazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është ndryshuar, duke e refuzuar të pabazuar ankesën e subjektit politik Vetëvendosje (LVV).

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, dhe 34 paragrafi 1 pika 1.11, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË

AA.nr.40/2025, datë 07.02.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
AKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Funksioneri i autorizuar
Ovlašćeni radnik

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka



SEKRETARIATI I KËSMILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

77-40/2025

DOSTAVNIKA ZA-LICNO DOSTAVLANJE

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

Numri i shtojcave:
broj priloga

Vértetoi se mora sikresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

Shkaku i refuzimit të martesës
Razlog albijnja priunea

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Pospis primioa ili lica koje je
pismeno primilo u zameru)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavlaca

(Te panevojshmeve bjert vize - nepotrebnue prectat)

AKTGyűjtemény 07.02.2025

2

Ne tasi se marvest është an i llobet ose nuk është në dorëzuesi, duke shënuar shkaktim pse marrësi nuk. Ako je primilac nepismen, ni nje u stanju da se pot napomenom zasto primilac nje stavlja svoj podpis.

Form 12/08